



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2011/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI34/22

Parashtrues

Arbër Makolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr.144/2021 të 19 tetorit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arbër Makolli nga Prishtina, i cili përfaqësohet nga Fatbardh Makolli avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr.144/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.32/2016] të Gjykatës së Apelit të 12 nëntorit 2019 dhe Aktgjykimin [C.nr.1376/09] të 29 majit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar [Rev.nr.144/2021] të 19 tetorit 2021 e ka pranuar më 9 nëntor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22(Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

6. Më 9 mars 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 mars 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
8. Më 21 mars 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe nga ia kërkoi që të dorëzoi autorizimin për përfaqësim në procedurën para Gjykatës. Po ashtu u njoftua edhe Gjykata Themelore dhe nga ajo u kërkua që të sjellë fletkthesën që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të cilin e konteston. Një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 25 mars 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e Gjykatës Supreme.
10. Më 30 mars 2022, përfaqësuesi i parashtruesit dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
11. Më 8 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Faktet lidhur me procedurën e zhvilluar pranë organeve administrative

12. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ishte zyrtar policor në Policinë e Kosovës, përkatësisht kishte shërbyer si polic pranë Njesisë së Trafikut në regjionin e Prishtinës.
13. Sipas dosjes së lëndës, më 21 janar 2006, në një pikë kontrolli në relacionin Prishtinë-Podujevë afër vendit të quajtur "Kulin", parashtruesi i kërkesës dhe kolegu i tij B.H duke vepruar si pjesëtarë të Policisë së Kosovës, Njësia regjionale e trafikut Prishtinë, gjatë kontrollit rutinor kishin ndaluar 3 kamionë që transportonin mazut nga Serbia në Kosovë, ku nga shoferët e kamionëve kishin përfituar një shumë të të hollave prej 30 (tridhjetë) eurosh.
14. Më 21 janar 2006, në Policinë e Kosovës kishin dhënë deklaratë me shkrim dy qytetarë të Republikës së Serbisë, të cilët po atë ditë, veç e veç, me automjetet e tyre kishin kaluar nëpër territorin e Republikës së Kosovës dhe ishin ndaluar dhe kontrolluar nga patrulla e policisë. Vozitësi Z.N kishte deklaruar se nga policët i është kërkuar heqja e tabelave të kamionit, por pasi që bashkudhëtari i tij kishte biseduar me policët, atij i janë kthyer dokumentet dhe nuk i është kërkuar heqja e tabelave të regjistrimit. Ndërsa, vozitësi T.S në deklaratën e tij ndër të tjera kishte theksuar se policët e kanë ndaluar kamionin e tij, nuk i kanë kërkuar para, por ai në shenjë falënderimi ka hedhur 30 euro në automjetin zyrtar të policisë, të cilat para ka mundësi që policët nuk i kanë parë pasi që ishte natë dhe errësirë.
15. Në të njëjtën datë, parashtruesi i kërkesës ishte intervistuar lidhur me rastin e raportua për keqpërdorim të detyrës zyrtare, me ç' rast kishte deklaruar se *"me datë 21.01.2006, lidhur me rastin e raportuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, paditësi është intervistuar në SHPK, me ç'rast veç tjerash në procesverbal ka deklaruar se me datë 21.01.2006 derisa ishte në detyrat e punës, me kolegun kanë bërë kontrollin e rregullsisë së dokumenteve të disa automjeteve në rrugën magjistrale Prishtinë - Podujevë [...] kamionin të cilin e ka ndaluar ai, ka pasur parafrangën e thyer dhe për këtë arsye ka dashur që vozitësit t'ia shqiptojë gjobën por meqë i janë dhënë disa të holla- gjobën nuk e ka shqiptuar [...]".* Gjithashtu kishte deklaruar se asnjëherë më parë nuk ka pranuar para, ndërsa ndihet i penduar për këtë rast prandaj edhe e ka treguar të vërtetën.
16. Më 21 janar 2006, Komandanti Regjional i Njesisë së Trafikut në Prishtinë përmes vendimit SHPK KPP/AD, e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se që nga data 21 janar 2006 ora 17:00 suspendohet me pagesë nga puna në kohëzgjatje prej 48 orë, për shkak të dyshimit për keqpërdorim të detyrës zyrtare për të cilën ishin hapur hetimet.
17. Më 23 janar 2006, Drejtoria e Standardeve Profesionale kishte filluar hetimet e brendshme ndaj parashtruesit të kërkesës dhe kolegut të tij B.H nën dyshimin se të njëjtit kishin vepruar në kundërshtim me parimet dhe procedurat e Shërbimit Policor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: SHPK-së), për shkak se kishin keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, ashtu që me datë 21 janar 2006 në fshatin Lupq i Poshtëm kanë ndaluar 3 kamionë me mazut dhe kanë pranuar ryshfet në vlerën prej 30 euro, e cila shumë parashtruesit të kërkesës i është gjetur në xhep nga kapiteni E.B dhe S.K.
18. Më 6 shkurt 2006, parashtruesi i kërkesës kishte dhënë intervistën e dytë në SHPK, në prani të avokatit kishte deklaruar "se më 21.01.2006, ka qenë në detyrë në magjistralen Prishtinë - Podujevë dhe me atë rast i ka ndaluar disa vetura dhe autocisterna[...] dhe meqë kishte gjetur parregullsi në autocisternën e dytë ka dashur

që të shqiptoj gjobën, por pas lutjes së një qytetari të moshuar [...]ka vendosur që të mos shqiptoj gjobë. Po ashtu kishte deklaruar se më vonë kishte vërejtur që në veturën zyrtare ishin paratë [...] kishte bërë përpjekje për ta kontaktuar bazën për këtë ngjarje, por nuk kishte mundur pasi radiolidhja nuk ka qenë në rregull gjersa në telefonin e dorës nuk ka pasur mbushje".

19. Më 1 mars 2006, në një deklaratë vullnetare të dhënë nga parashtruesi në SHPK, parashtruesi theksoi se në një intervistë të datës 21.01.2006, ai ka pranuar veprën për të cilën akuzohej – marrje ryshfeti, nga frika se mos ndalohej. Sipas deklaratave, frika ka ardhur për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore të babait të tij, i cili kishte një ndërhyrje në zemër dhe shëndetit të nënës së tij, e cila ishte e sëmurë dhe për këtë arsye nuk donte t'i shqetësonte.
20. Më 21 qershor 2007, parashtruesit të kërkesës i ishte dërguar njoftimi shtesë për hetimet e brendshme, pasi është supozuar se ka shkelur Rregulloren e SHPK-së, përkatësisht rregullat e sjelljes dhe kryerjes së detyrës.
21. Në hetimin e brendshëm është përcaktuar që parashtruesi *"në fillim kur është intervistuar, paditësi ka pranuar se i ka marrë paratë mirëpo, në deklaratën e dytë ka mohuar këtë vepër. Po ashtu gjatë hetimeve janë intervistuar edhe Nebi Rrafshi qytetar Zoran Nesić dhe Slobodan Tomić të cilët janë deklaruar për shumat që kanë dhënë. Për më tepër duke marrë parasysh se paditësi ka dhënë deklarata të ndryshme, ai është akuzuar edhe për mos sinqeritet. Prandaj nga këto arsye dhe pas përfundimit të procedurave të brendshme ku është vërtetuar shkelja disiplinore, e paditura ka vendosur që paditësit t'i shqiptohet masa disiplinore largim nga puna."*
22. Më 10 gusht 2007, Njësi i Standardeve Profesionale pranë Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: NJSP), përmes Vendimit 021-SHPK-020067, parashtruesit të kërkesës i kishte shqiptuar masën disiplinore largim nga detyra, pasi që ishin hetuar dhe gjetur të aprovuara akuzat lidhur me standardin e sjelljes.
23. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë, kundër Vendimit të NJSP-së 021-SHPK-020067 përmes të cilit ishte larguar nga detyra.
24. Më 5 dhjetor 2007, Komisioni i Ankesave të Drejtorisë së Personelit të SHPK-së në Prishtinë përmes Vendimit Ref DP9827/D, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e NJSP-së.

Faktet sa i përket procedurës gjyqësore në lidhje me aktakuzën për kryerjen e veprës penale marrje e ryshfetit

25. Më 24 shkurt 2006, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Publike) kishte ushtruar propozim akuzë [PP.nr.600-14/2006] kundër parashtruesit të kërkesës dhe B.H për shkak të kryerjes së veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.3 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK). Ndërsa më 15 prill 2011 kishin precizuar aktakuzën në drejtim të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.
26. Më 30 janar 2012, Gjykata Komunale në Podujevë përmes aktgjykimit [P.nr.224/2006], liroi nga aktakuza parashtruesin e kërkesës dhe personin B.H.
27. Në një datë të pasaktësuar, Prokuroria publike paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë.

28. Gjykata e Apelit përmes aktvendimit [PAKR.1035/12] aprovoi ankesën e Prokurorisë publike ku prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe lëndën e riktheu në rigjykim.
29. Më 25 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes aktvendimit [PKR.nr.432/13] hodhi poshtë aktakuzën e Prokurorisë publike [PP.nr.600-14/2006] të 15 prillit 2011, dhe vendosi që të pushohet procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit B.H për shkak se ishte bërë parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Faktet lidhur me procedurën gjyqësore për rikthim në vendin e punës

30. Më 12 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, ku kërkoi që të (i) anulohet si i kundërligjshëm vendimi i Drejtorisë së Personelit të SHPK-së Ref DP9827/D i 5 dhjetorit 2007; (ii) detyrohet e paditura që parashtruesin ta kthejë në punë dhe detyra të punës si polic me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës duke filluar prej datës 10 gusht 2007 duke përfshirë edhe pagesën e të ardhurave personale në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit të detyrueshëm.
31. Më 29 maj 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.1376/09] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
32. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e parashtruesit ose aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.
33. Më 12 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.32/2016] refuzoi të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.1376/09] të 29 majit 2015 e vërtetoi.
34. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të prishen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
35. Më 19 tetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.144/2021] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.32/16 të 12 nëntorit 2019.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev.nr.144/2021] e 19 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
37. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk qëndron konstatimi i Gjykatës Supreme se në rastin e tij aktvendimi i Gjykatës Themelore PKR432/13 i 25 janarit 2016 nuk qenka vendim për shkak të lirimit nga akuza por qenka aktvendim për pushimin e

procedurës për shkak të parashkrimit absolut. Sipas parashtruesit ky arsyetim i gjykatës Supreme është “i padrejte ne kuptim të respektimit të parimit të barazisë para Ligjit të të gjithë individëve i garantuar me nenin 3.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nëse mungon azhurnimi i punës së Gjykatës për të cilën pala paditëse nuk është faktor as i përshpejtimin të procedurës e as i ngadalësimit të punës së Gjykatës, ky joazhuret i institucioneve Gjyqësorë të Kosovës nuk duhet interpretuar në dëme të palës, por në dëme të Institucionit i cili për fajin e tij lëndën e ka dërguar ne parashkrim”.

38. Prandaj, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“nuk qëndrojnë konstatimet e Gjykatës Supreme se gjykatat e dy instancave më të ulëta se kinse veprimet e paditësit janë në kundërshtim me parimet e sjelljes së Policisë së Kosovës”*. Sipas parashtruesit konstatimet e tilla janë të pabazuara dhe në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit, për shkak se sjelljet e tij kanë qenë konform rregullave dhe akteve të Policisë dhe se me asnjë provë nuk ishte konstatuar se ai kishte bërë shkelje të akteve të brendshme të Policisë së Kosovës. Sipas parashtruesit ai nuk ka shkelur aktet e brendshme të Policisë, por edhe nëse do i shkelte, parashtruesi pretendon se ka bërë gabim të paqëllimshëm dhe për këtë është dashtë t’i shqiptohet masa prej 30 ditësh suspendim pa pagesë, për arsye se sipas tij me asnjë provë nuk është dëshmuar se i njëjti ka bërë shkelje të rënda disiplinore. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim të plotë me parimin *In dubio pro reo*, për arsye se në rastin e tij Gjykata Supreme ka bërë “shkelje flagrante” të neneve 3, 22, dhe 24 të Kushtetutës, si dhe parimeve të sanksionuara me Kushtetutë dhe Konventa ndërkombëtare dhe të cilat janë të aplikueshme në praktikë.
39. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në esencë, thekson se Gjykata Supreme ka konstatuar gabimisht bazën juridike, për shkak se *“ askund nuk është bere konstatimi i një fakti juridik se paditësi me Aktvendimin P nr.224/2006 dt.30.01.2012 të ish Gjykatës Komunale në Podujeve, paditësi është liruar nga Aktakuza, se i njëjti Aktgjykim është nxjerre duke i administruar të gjitha provat e tij në veçanti deklarata e S.T i cili e konfirmon se paditësi asnjëherë nuk ka kërkuar para dhe se i njëjti e ka shfrytëzuar errësirën dhe i ka gjuajtur në dysheme parat në shumë prej 30 euro, pra të gjitha këto prova janë administruar dhe është vërtetë gjendja faktike në raport me aktvendimin për hedhjen e aktakuzës për shkak të parashkrimit që Gjykata Supreme e merr si bazë në kualifikimin e kinse shkeljeve disiplinore të paditësit. Po ashtu Gjykata fare nuk i ka marr parasysh shkeljet dhe arbitraritetin e policisë së Kosovës e cila masën e cila masën e simulimit e kanë bërë në mënyrë arbitrare pa urdhër të prokurorit apo gjyqtarit të procedurës paraprake”*.
40. Parashtruesi i kërkesës më tej ndër të tjera thekson se : *“nga momenti përkatësisht data e parë e intervistimit dt.21.01.2006 në Policinë e Kosovës, është bere ne kundërshtim të plote me Ligjet ne fuqi duke ja mohuar te drejtat elementare te njeriut përkatësisht nenin 22 Kushtetutës së Kosovës - Deklaratën Univerzale për të drejtat e njeriut e cila ja garanton qytetarit respektimin e te drejtave elementare te njeriut. Në këtë interviste, Paditësit i është mohuar e drejta ne konsultim me mbrojtës pra dhënien e deklaratës ne prezencën e avokatit mbrojtës, i është ushtruar presion psikik me shqetësim ngase hetuesi ka pasur dijeni se paditësi i ka pasur te sëmure dy prindërit dhe atë babanë atë dite e ka operua ne Kardiokirurgji operacion i hapur ne zemër, kurse nënën me dializë, pastaj nuk është bërë incizimi i marrjes ne pyetje duke vazhduar intervistimi për 8 ore rresht pa asnjë minute pauze apo marrjen e ushqimit. Këto veprime janë ne kundërshtim të plote me te drejtat e qytetareve te garantuara me Kushtetute. Këto janë në kundërshtim të plote edhe me vete aktet normative të MPB-së, Policisë së Kosovës, përkatësisht Rregullores së brendshme aneksi "C" për P-4.16 Marrja ne pyetje e Policëve të SHPK-së : Obligimet,*

të Drejtat dhe Mbrojtja e Punonjësit si pjesë përbërëse e Rregullores së Policisë e emëruar "SHPK-Parimet dhe Procedurat si Akte Normative që kanë qenë në Fuqi".

41. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që : (i) të pranohet dhe vlerësohet kërkesa; dhe (ii) aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.144/2021 i 19 tetorit 2021 të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim në Gjykatën Supreme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

- 1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
- 2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantojnë me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*
- (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.*

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*
[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113 **[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]**

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
[...]

44. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 **[Kërkesa individuale]**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48 **[Saktësimi i kërkesës]**

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

45. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.144/2021] e 19 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

46. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

47. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe K175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

48. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të

pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin KIo4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

49. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIo4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
50. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë me largimin nga puna të parashtruesit të kërkesës në Policinë e Kosovës, për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës. Parashtruesi i kërkesës fillimisht ishte suspenduar me vendim të Komandantit të Stacionit për shkak të dyshimit të shkeljes së detyrave të punës përkatësisht për shkak të marrjes së ryshfetit. Pas zhvillimit të hetimeve NJSP përmes vendimit 021-SHPK-020067, parashtruesit të kërkesës i kishte shqiptuar masën disiplinore largim nga detyra, pasi që ishin hetuar dhe gjetur të aprovuara akuzat lidhur me standardin e sjelljes, të cilin vendim e kishte vërtetuar edhe Komisioni i Ankesave të Drejtorisë së Personelit të SHPK-së në Prishtinë përmes vendimit Ref DP9827/D. Parashtruesi i kërkesës më tej kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore ku kishte kërkuar që të anulohet vendimi Ref DP9827/D i Komisioni i Ankesave të Drejtorisë së Personelit të SHPK-së dhe që të kthehet në vendin e tij të punës. Gjykata Themelore refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë të cilën ankesë Gjykata e Apelit e shpalli të pathemeltë dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ku kërkoj që të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ultë dhe lënda të kthehet në rigjykim. Gjykata Supreme nëpërmjet aktgjykimit Rev.nr.144/2021 refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës.
51. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
52. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe ii) shkeljet e pretenduara të neneve 3, 22, 24 dhe të Kushtetutës.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

53. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës qëndron në pretendimin se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke arsyetuar “ *sa i përket bazës juridike që gabimisht e ka konstatuar Gjykata Supreme, askund nuk është bere konstatimi i një fakti juridik se paditësi me Aktvendimin P nr.224/2006 dt.30.01.2012 te ish Gjykatës Komunale ne Podujeve, paditësi është liruar nga Aktakuza, se i njëjti Aktgjykim është nxjerrë duke i administruar te gjitha provat e në veçanti deklarata e S.T i cili e konfirmon se paditësi asnjëherë nuk ka kërkuar para dhe se i njëjti e ka shfrytëzuar errësirën dhe i ka gjuajtur në dysheme parat në shumë prej 30 euro, pra të gjitha këto prova janë*

administruar dhe është vërtetë gjendja faktike në raport me aktvendimin për hedhjen e aktakuzës për shkak të parashkrimit që Gjykata Supreme e merr si bazë në kualifikimin e kinse shkeljeve disiplinore të paditësit. Po ashtu Gjykata fare nuk i ka marrë parasysh shkeljet dhe arbitraritetin e policisë së Kosovës e cila masën e simulimit e kanë bërë në mënyrë arbitrare pa urdhër të prokurorit apo gjyqtarit të procedurës paraprake”.

54. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykatat e rregullta.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “Adem Jashari”, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
56. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aplikimi nr.30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe rastet e Gjykatës KI128/18, të cituara më lartë, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, paragrafi 58).
57. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
58. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.1376/09], refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se “[...] Pas shqyrtimit me kujdes dhe ndërgjegje të secilës prove veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën gjykata, kërkesëpadinë e paditësit e gjeti në tërësi të pabazuar, pasi paditësi nuk ka arritur t’i mbështes pohimet për montimin e veprës penale respektivisht se paditësi në të vërtetë nuk është përgjegjës për shkeljet disiplinore për të cilat është larguar nga detyra.. [...] Gjykata përkujton se në këtë çështje kontestimore është shqyrtuar procedura e brendshme disiplinore, gjendja faktike si dhe shkeljet eventuale ligjore nga ana e të paditurës në raport me hetimet e zhvilluara disiplinore ndaj paditësit dhe se gjykata në rastin konkret nuk është e lidhur me procedurën e zhvilluar penale dhe as me aktgjykimin penal, të cilit vendim paditësi i është referuar, por nuk e ka prezantuar si prove. Në këtë kuptim gjykata gjeti se e paditura ka zhvilluar procedure të mirëfilltë disiplinore dhe si përfundim, paditësi përveç për shkelje të rëndë disiplinore - marrje ryshfeti (korrupsioni), e përcaktuar si shkelje disiplinore në dispozitën e nenit 5.3, pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54, është gjetur përgjegjës edhe për shkelje të parimeve të Rregullores në fjale dhe Parimeve dhe

procedurave te ShPK-së, - sinqeriteti si dhe për moslajmërim ne Polici gjatë periudhës hetimore dhe atë 13 dite gjate vitit 2006 dhe tre dite gjate vitit 2007".

59. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.32/2016] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera theksoi " [...] ashtu siç ka theksuar gjykata 'e shkalles se pare edhe Gjykata e Apelit vlerëson se nga provat e administruara justifikohet ne tërësi veprimi i të paditurës për largimin e paditësit nga puna sepse e paditura ka zhvilluar procedure te mirëfilltë disiplinore ku ne këtë procedure është vërtetuar se paditësi ka bere shkelje te renda disiplinore ku ka ardhur deri te largimi i tij nga puna. Gjykata e Apelit e jep këtë vlerësim duke u mbështetur në detyrën e kësaj gjykate qe te kujdeset sipas detyrës zyrtare për zbatimin e te drejtës materiale, andaj edhe rithekson se përfundimi i gjykatës se shkalles së parë është i drejte, i ligjshëm dhe bindes. Ne kuptim të të cekurave kjo gjykate vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet për zbatim te gabuar të së drejtës materiale pasi qe gjendja e konstatuar nga gjykata e shkalles se pare është në harmoni me normat materiale te cilat janë zbatuar ne rastin konkret".
60. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në tërësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit Rev.nr.144/2021, ndër të tjera arsyetoi "[...] Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar si te pabazuara thëniet e revizionit se gjykata e shkalles se pare dhe ajo e shkalles se dyte nuk kane marre për baze faktin se Gjykata Themelore ne Prishtine me aktvendimin e saj P.nr 432/13 të datës 25.1.2016 ka hedhur aktakuzën e prokurorisë dhe ka pushuar hetimet ndaj paditësit dhe se gjykata është e lidhur me aktgjykimin penal si çështje paraprake, këto pretendime nuk qëndrojnë nga arsyeja se me aktvendimin e Gjykatës Themelore ne Prishtine: PKR 432/13 te datës 25.1.2016 është hedhur, akuza e PPK ne Prishtine dhe pushohet procedura penale kundër paditësit dhe B.H për shkak veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së , për shkak të parashkrimit absolut te veprës penale, jo për shkak të lirimit nga akuza .Por përkundër faktit se është zhvilluar procedura penale e njëjta nuk ka përjashtuar mundësinë që ndaj paditësit të zhvillohet procedura disiplinore dhe të shqiptohet masa disiplinore. Paditësi i është shqiptuar masa disiplinore e ndërprerjes se marrëdhënies së punës për shkak te shkeljeve te rënda te detyrave te punës nga Doracaku i Parimeve dhe Procedurave në Policinë e Kosovës parimi P.1.8 .Është qëndrimi i drejtë i gjykatave të instancës ma te ulte se veprimet e paditësit janë në kundërshtimin me Parimet e sjelljeve te Policisë së Kosovës të cilat parime janë mjaft të qarta dhe të konkretizuara, prandaj pretendimet e paditësit se këto parime janë shume te përgjithësuara nuk qëndrojnë [...]".
61. Gjykata vëren se Gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përfshirë edhe pretendimin se nuk e kishte marrë për bazë se ai ishte liruar nga akuza me vendim të Gjykatës Komunale të Podujevës P nr.224/2006 të 30 janarit 2006. Lidhur me këtë Gjykata vëren se vendimi në fjalë nuk ishte vendim i formës së prerë për shkak se ai ishte rikthyer në rigjykim nga ana e Gjykatës së Apelit. Thënë këtë Gjykata vëren se vendimi i fundit ishte ai i Gjykatës Themelore PKR 432/13 i 25 janarit 2016, përmes të cilit Gjykata Themelore kishte konstatuar që procedura penale pushohet për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, por jo për shkak të lirimit nga akuza, gjë që ishte vërtetuar edhe përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme të cituar më lartë. Po ashtu procedura penale nuk e përjashton mundësinë që ndaj parashtruesit të zhvillohet procedura disiplinore.
62. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të

procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; dhe KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

63. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, thekson se, Gjykata Supreme "ka konstatuar gabimisht bazën juridike", megjithatë ai nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë "qartazi i gabuar", duke rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih rastet e Gjykatës KI64/20, parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
64. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që bien në kategorinë e "shkallës së katërt" dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 3, 22 dhe 24 të Kushtetutës

65. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenet 3, 22 dhe 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë "të pambështetura apo të paarsyetuara" ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
 - a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* i 31 majit 2005, kërkesa nr. 4241/03; shih gjithashtu, *Baillard kundër Francës (vendim)* i 25 shtatorit 2008, kërkesa nr. 6032/04);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata

vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

66. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ka shkelur të drejtat e tij individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e neneve 3, 22 dhe 24 të Kushtetutës, duke theksuar “*nuk qëndrojnë konstatimet e Gjykatës Supreme se gjykatat e dy instancave më të ulëta se kinse veprimet e paditësit janë në kundërshtim me parimet e sjelljes së Policisë së Kosovës*” si dhe duke iu referuar parimit *In dubio pro reo*, por nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës KI175/20, parashtues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, cituar më lart, paragrafët 38- 39).
67. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës për shkelje neneve 3, 22 dhe 24 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, pasi parashtuesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

68. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtuesit të kërkesës është e papranueshme, sepse: (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt” dhe si të tilla këto pretendime të parashtuesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; dhe (ii) pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 22 dhe 24 të Kushtetutës, duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 qershor 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Lajvan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani